



Viti i VIII-të i Botimit, Nr.2,
Dhjetor 2017

ZHVILLIMI URBAN I QYTETIT TË LIBRAZHBIT

Eranda Shalsi*, Sabina Bollano*

Departamenti i Arkitekturës, Fakulteti i Shkencave të Aplikuara, Albanian University

Adresë kontakti: *ark.eralici@gmail.com*

Përmbledhje

Fokusi: Librazhdi, ashtu si shumë qytete të tjera të Republikës së Shqipërisë zgjodhën ta sfidonin kaosin dhe tranzicionin urban të këtyre viteve duke hartuar Planin e Përgjithshëm Vendor. Ky plan ishte një domosdoshmëri për zhvillimin e qëndrueshëm urban, duke sjellë një vizion të ri për bashkëpunimin mes qendrave urbane dhe infrastrukturës, biodiversitetit, bujqësisë, burimeve natyrore, etj.

Metodologjia: Nëpërmjet projekteve strategjike do të përcaktohet bashkëveprimi ekonomik dhe territorial, mjaft i nevojshëm për të arritur një balancë të qëndrueshme të zhvillimit të qytetit. Koncepti strategjik i PPV Librazhd identifikon planet specifike afatgjata që do të shërbejnë për të drejtuar proceset e transformimit sipas një vizioni funksionalist të PPV.

Rezultatet: PPV Librazhd ndalon zgjerimin në zonat rurale, rigjeneron tokat bujqësore, parashikon rritjen e punësimit dhe prodhimit për tregjet agro-ushqimore lokale. Mundëson riaktivizimin dhe ripërdorimin e sistemit të minierave të nikelit dhe të kromit. Ky plan synon zhvillimin e turizmit malor bazuar në rritjen, vlerësimin dhe vënien në pah të rrjeteve të burimeve natyrore. Parashikon ripërdorimin e ndërtesave rurale për qëllime agro-turistike, krijimin e një sistemi të rrugëve dhe shtigjeve, si edhe planifikimin e zonave rekreative dhe sportive.

Përfundimet: Pas analizave ekonomike, PPV Librazhd rekomandon rritjen e numrit të ndërmarrjeve, të cilat duke punuar së bashku në fushat e bujqësisë, pyjeve dhe të energjive të rinovueshme, do të jenë në gjendje të sjellin rigjenerimin e ekonomisë urbane, të sigurojnë forma të integritetit dhe të punësimit për qytetarët. Ky plan rrit mjaftueshëm shërbimet e infrastrukturës dhe objekteve të komunitetit, ndalon zgjerimin e parregullt dhe plotëson hapësirat pjesërisht të urbanizuara, duke i dendësuar dhe duke i zhvilluar ato sipas standardeve të një planifikimi të qëndrueshëm urban.

Fjalët kyçe: *ekonomi, infrastrukturë, plani i përgjithshëm vendor, qytet, i qëndrueshëm, urban*

URBAN DEVELOPMENT OF LIBRAZHD CITY

Abstract

Focus: Librazhd, like many other cities of Albania Republic chose to challenge the chaos and urban transition of these years by composing the General Local Plan. This plan was a necessity for sustainable urban development, bringing a new vision for cooperation between

urban centers and infrastructure, biodiversity, agriculture, natural resources, etc.

Methodology: Through strategic projects will be determined the economic and territorial interaction, quite necessary to achieve a sustainable balance of city development. The Strategic Concept of Librazhd GLP identifies specific long-term plans that will serve to guide the transformation processes according to a functionalist vision of GLP.

Results: Librazhd GLP prohibits the expansion in rural areas, regenerates agricultural lands, envision employment growth and production for local agri-food markets. It enables the reactivation and reuse of the nickel and chrome mining system. This plan aims the development of mountain tourism based on growth, evaluation and highlighting of natural resource networks. It foresees the reuse of rural buildings for agritourism purpose, construction of roads and paths system, as well as the planning of recreational and sports areas.

Conclusions: After economic analysis, Librazhd GLP recommends increasing the number of enterprises that, working together in the fields of agriculture, forestry and renewable energies, will be able to bring the regeneration of urban economy, will provide integration forms and employment for citizens. This plan sufficiently enhances infrastructure services and community facilities, prohibits abnormal expansion, and complements partial urbanized spaces, by expanding them and developing them according to standards of sustainable urban planning.

Keywords: *economy, infrastructure, general local plan, city, sustainable, urban*

Hyrje

Që prej qershorit 2015, 61 bashkitë në Shqipëri, produkt të reformës administrative territoriale, u përballën me sfidat e pushtetit vendor, të shumëfishuara si pasojë e rritjes së sipërfaqes dhe kompleksitetit territorial, shtimit të detyrave të reja nga reforma e decentralizimit, dhe nevojës gjithmonë në rritje për zhvillim dhe mirëqenie sociale dhe ekonomike. Plani i Përgjithshëm Vendor (PPV) Librazhd është hartuar nga Bashkia Librazhd, A & E Engineering dhe Cooprogetti S.C.R.L, të mbështetur nga Ministria e Zhvillimit Urban dhe nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit. Bazuar në gjithë materialet e ofruara nga Bashkia Librazhd, ne e kemi marr këtë PPV si një rast studimor, duke vlerësuar punën voluminoze dhe mjaft profesionale të zhvilluar nga palët e sipër përmendura dhe jemi duke analizuar metodologjinë e hartimit të PPV, komponentët kryesor të saj, si edhe projektet strategjike të propozuara për një zhvillim të qëndrueshëm të qytetit.

1. Objektivat e Planit të Përgjithshëm Rregullues të Qytetit të Librazhdit

PPV Librazhd synon të respektojë në maksimum vlerat natyrore dhe historike të territorit. Objektivat e Planit të Përgjithshëm Rregullues të Librazhdit janë si më poshtë:

- Shfrytëzimi i avantazheve që vijnë si rezultat i rajonit ku është vendosur Librazhdi, si edhe rivitalizimi dhe bërja e lexueshme e elementeve qytetformuese.
- Rikonceptimi i “makrostrukturës” së qytetit përmes konceptimit dhe krijimit të “fashës së pajisur” multifunkionale, që do të mbështesë tezën e “Librazhdit qytet Rajonal”. Kjo do të kërkojë kryesisht ndërtimin e strukturave të reja me këtë përqsje.
- Realizimi i lidhjeve sa më optimale të qytetit me superstradën dhe përcaktimi i funksioneve dhe kufijve në qasjen direkte me të.
- Rritja e gamës së funksioneve ekzistuese në qytet, me fokus kryesor rritjen e hapësirave

- publike, të gjelbra dhe argëtuese.
- Identifikimi i hapësirave të nevojshme për vendosjen e bizneseve brenda territoreve të qytetit dhe në zona të reja.
 - Integrimi i vendbanimeve të parregullta në periferi me pjesën tjetër të qytetit .
 - Identifikimi i mekanizmave të nevojshëm teknikë/ urbanistikë dhe administrativë për përmirësimin e hapësirave të brendshme të njësive të banimit.
 - Përcaktimi i mekanizmave të nevojshëm urbanistikë për sigurimin e banesave sociale.
 - Përcaktimi i përdorimeve sa më optimale për sipërfaqet e pashfrytëzuara brenda vijës kufizuese ekzistuese, si edhe të zonave apo objekteve ish-ekonomike të cilat aktualisht janë jashtë funksionit.
 - Identifikimi i hapësirave të reja të shtrirjes së qytetit dhe përcaktimi i destinacioneve të tyre.
 - Përcaktimi i skemës së përgjithshme të rrjetit rrugor dhe mënyrës së funksionimit me synim kryesor lehtësimin e lidhjeve nga sektori në sektor.
 - Përcaktimi i kufirit të sipërm të rritjes së qytetit.
 - Përcaktimi i një “lidhësi lumor” që do të shërbejë për të “afruar” qytetin me lumin, si elementi kryesor qytetformues.
 - Bashkërendimi i skemës së re të zhvillimit të qytetit me rrjetin e përgjithshëm të infrastrukturave (ujësjellës, kanalizime, furnizim me energji elektrike, telefoni).
 - Përcaktimi i qartë i njësive strukturore të qytetit sipas të cilave do të hartohen studimet urbanistike pjesore për të gjitha pjesët e qytetit, si dhe formulimi i qartë për secilën prej tyre: kushtëzimet urbanistike, treguesit urbanistikë e shërbimet sociale, të cilat duhet të merren parasysh gjatë hartimit të studimeve urbanistike pjesore (1).

2. Analiza dhe vlerësimi i pozicionit strategjik

Bashkia e Librazhdit, e pozicionuar në Qarkun e Elbasanit, me një sipërfaqe totale 1 404,87 km², përfshin në vetvete njësitë administrative të Qendrës, Hotolishtit, Polisit, Orenjës, Lunikut dhe Stëblevës. Në përfundim të saj kufizohet me Bashkinë e Elbasanit, në jug me Bashkinë e Përrenjasit, në veri nga Bashkia e Tiranës dhe ajo e Bulqizës, ndërsa në lindje me kufirin ndërshtetëror.

2.1 Topografia dhe klima

Pozita gjeografike, konfiguracioni i relievit, lartësia absolute mbi nivelin e detit dhe largësia nga deti Adriatik ka mundësuar natyrën kontinentale të klimës e cila duket në dimrin e ftohtë e të lagësht dhe në verën e shkurtër, të nxehtë e të thatë. Klima është e ndryshme. Në luginë ajo është e butë. Në ngrehinat malore dhe shpatet e tyre, bëhet më e ftohtë në dimër dhe e freskët në verë. Klima e zonës së Librazhdit në tërësinë e saj është mesdhetare paramalore e malore me element kontinental. Temperaturat mesatare lëvizin nga 6.3° C në janar deri 22° C në gusht. Ekstremet e temperaturës janë 40.5° C në verë dhe -15.5° C në dimër. Zona karakterizohet nga një regjim intensiv reshjesh ku mesatarja vjetore është 1378 mm reshje/vit (1).

2.2 Relievi lumor

Relievi lumor përfaqësohet nga përrrenjtë malor të tipit erozional. Kryesisht ata janë përrrenj në thellim, në grykëderdhjen e tyre kanë formuar freskoren e tipit aluvjalo-proluvjal, duke krijuar territore të rrafshëta 4 - 5°. Lugina më kryesore e kësaj zone është lugina e Shkumbinit, e cila përfaqëson një luginë në formë “U” dhe shpesh në formë “V” me fund pak a shumë të rrafshët (1).

2.3 Zonat e mbrojtura natyrore dhe të trashëgimisë kulturore e historike

Në bashkinë Librazhd, në njësinë administrative të Stëblevës gjendet fshati Steblevë, një perlë e paprekur e turizmit malor dhe natyrës piktoreske.

Stebleva është një teatër natyror, një gërshetim i mahnitshëm i lëndinave, pyjeve, kodrinave, maleve dhe lumenjve. “Maja e Zezë”, e cila ndodhet në lartësinë 2225 m mbi nivelin e detit, është maja më e lartë në këtë zonë. Stebleva përshkohet nga përrenj dhe kroje të shumtë. Jo më pak kureshtje zgjon dëshira për të vizituar liqenin karstik të malit të Draganit. Shkëmbinjtë monumentalë që e karakterizojnë, të gdhendur nga vetë natyra ndër shekuj, krijojnë një peizazh natyror vërtet miklues.

Të mahnitshme janë pllajat dhe lëndinat e Visharicës, malit të Kallkanit e Mllacit, të cilat përbëjnë një nga pjesët më tërheqëse të Steblevës, të përshtatshme për aktivitetet sportive gjatë muajve të verës dhe pistat natyrore për ski, gjatë sezonit të dimrit. Në vitet para 90-ës, kjo zonë është shfrytëzuar për të mirat materiale që dispononte, kryesisht lëndën drusore, blegtorinë dhe bimët mjekësore. Për afro pesë dekada, kjo zonë është lënë në mëshirë të fatit. Mundësitë e investimeve në këtë krahinë janë më të larta me shpalljen e masivit “Studën - Kallkan - Jabllanicë - Kodra e Borovës - Dragan”, që është shpallur zonë e mbrojtur.

Ujërat

Brenda parkut gjenden mbi 14 liqene akullnajore të vegjël me bukuri madhështore, të cilët ndodhen në një lartësi mbi 1900 metra mbi nivelin e detit. Janë gjithashtu dy lumenj që rrjedhin përmes zonës së Parkut me një gjatësi prej 22 km, përfshirë në veri lumin e Qarrishtës që bashkohet me lumin Rrapun dhe në jug lumin e Bushticës që bashkohet me lumin Shkumbin.

Klima në shumicën e parkut bie në kategorinë e klimës mesdhetare, me temperatura mesatare vjetore ndërmjet 7 ° C dhe 10 ° C. Reshjet mesatare vjetore janë midis 1.300 mm dhe 1.800 mm.

Rishikimi i literaturës

Në erën e re të planifikimit urban në Republikën e Shqipërisë, të bësh një analizë të territorit dhe interpretimit të tij për PPV, do të thotë maturim i një procesi njohës intensiv, jo më si një grup tematikash të pakuptimta dhe të veçuara, por nëpërmjet aparateve të vërtetë njohës, të strukturuar dhe të përditësuar.

Analizat urbane dhe territoriale, si edhe sinteza e tyre, në mbështetje të Planifikimit Strategjik dhe Operacional janë trajtuar si një sistem i integruar i informacionit dhe të dhënave, që synon njohjen sistematike të aspekteve fizike dhe socio-ekonomike të territorit, zhvillimin dhe planifikimin rajonal dhe atë në nivel lokal, të nevojshëm për të kuptuar çështjet e trajtuara në planin urbanistik (analiza, studimi dhe planifikimi në përputhje me 5 sistemet territoriale) (2).

Aparati njohës përfaqëson të gjithë analizat paraprake, rastet studimore analitike dhe analiza të thelluara tematike të nevojshme për të identifikuar elementet njohëse të territorit, duke përmbledhur ato më të rëndësishmet për secilin nga sistemet e ndryshme që e përshkruajnë atë.

Qëllimi thelbësor i këtyre analizave është që të lejojë identifikimin e të gjitha elementeve karakterizuese të territorit (të urbanizuar dhe jo të urbanizuar), të nevojshëm për të vlerësuar zgjidhjet e përshtatshme, të qëndrueshme për transformimin dhe rihvillimin, si dhe për planifikimin lokal më koherent. Analizimi i thelluar i territorit dhe përgatitja e bazës për kristalizimin e strategjisë së zhvillimit të tij, është një proces me shumë rëndësi në përcaktimin e formës dhe mënyrës së zhvillimit perspektiv urban dhe rural.

3. Kuadri ligjor në Shqipëri

Kuadri ligjor për përgatitjen e PPV është pjesë e rregullores së planifikimit. PPV qëndron, në një kuadër të ri me nevojën, nga njëra anë, me rregullat që rrjedhin nga rregullorja e re e planifikimit, të përcaktuar në aspektet e saj strukturore dhe metodologjike, por nga ana tjetër, me tërësinë e vështirësive të zbatimit që kanë nevojë për dokumente sqaruese dhe teknike midis bashkive, AKPT dhe Ministrisë së Zhvillimit Urban.

Karakteristikat e reja kryesore të rregullores së re të planifikimit (3) në lidhje me mjetet e PPV mund të përmbliken si:

- Konceptimi nga ana territoriale si një “burim” dhe si grupim i elementeve natyrore, fizike, të ruajtura (jo të rinovueshme), por edhe historike, kulturore, etj., të cilat mundësojnë ruajtjen e identitetit të vendeve, dhe nga ana tjetër përcaktimin e përputhshmërisë ndërmjet burimeve dhe aktiviteteve të njeriut, duke tejkaluar vizionin e thjeshtë të kompetencave, që lejon zbulimin e modeleve dhe rregullave të mirësjelljes me territorin.
- Koncepti strategjik i PPV identifikon dhe përcakton vendosjen e elementeve përbërëse, të strukturës ekzistuese territoriale dhe që parashikon e lejon në projekt tejkalimin e një vizioni funksionalist të PPV për të drejtuar proceset e transformimit, duke rritur cilësinë e jetës me “identifikimin e planeve specifike strategjike afatgjata për zgjidhjet e projektimit”.
- Artikulimi operacional i zonimit në pakicë që specifikon të gjitha pjesët e territorit të ndarë në 5 sisteme dhe rregullon iniciativën publike përmes përfshirjes së operatorëve privatë në zbatimin e PPV (2).

Metodologjia

Metodologjia e ndjekur gjatë hartimit të PPV është mbështetur mbi analizën e të gjitha planeve ekzistuese, strategjive, planeve sektoriale, politikave, normave dhe standardeve, duke veçuar këtu analizën mjedisore e të metabolizmit, analizat territoriale, infrastrukurore, demografike dhe social-ekonomike, por edhe analizën SWOT, që janë bazat e nevojshme për një analizë të detajuar për hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor. Ky plan merr parasysh jo vetëm bazën e analizave shkencore e territoriale, por edhe nevojat, dëshirat e shprehura nga banorët dhe grupet e ndryshme të interesit në bashkinë Librazhd, nëpërmjet dëgjësive publike.

Metodologjia e hartimit të analizës së planeve të mëparshme është bërë duke i strukturuar ato në disa kategori kryesore. Ato janë ndarë në plane apo strategji të nivelit kombëtar, rajonal dhe vendor. Prej secilit dokument, janë identifikuar objektivat dhe disa nga masat kryesore të cilat mund të kenë implikime në hartimin e planit të ri të përgjithshëm vendor të bashkisë.

Qëllimet e përgjithshme të përcaktuara në PPV janë:

- Mbrojtja dhe përdorimi racional i burimeve natyrore dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe asaj natyrore;
- Një zhvillim i balancuar i zgjidhjeve, me theks të veçantë në aktivitetet ekonomike ekzistuese ose ato që zhvillohen brenda territorit të bashkisë;
- Plotësimi i nevojave të strehimit në lidhje me shërbimet dhe objektet e komunitetit me interes për bashkinë, që mund të arrihet kryesisht nëpërmjet rimëkëmbjes dhe plotësimit të zonave urbane dhe ndërtesave ekzistuese;
- Ekuilibri mes morfologjisë së territorit dhe ndërtesave, aftësia për zgjidhjen teorike të PPV dhe strukturës së shërbimeve.

Propozimi që është paraqitur, ka karakteristikat e përmendura më sipër dhe ka objektivat e përcaktuara nga Bashkia, të cilat përmbliken me pikat e mëposhtme me:

- Mbrojtjen dhe zhvillimin e tokës për qëllime ekonomike duke nxitur turizmin dhe bujqësinë.

- Përdorimin e tokës ndërtimore brenda perimetrit të përcaktuar në nivel ministror. Rregullat e ndërtimit përcaktojnë përdorimet e lejeve, të ndaluara ose me kusht, përcaktimin e zonave/njësive për densifikimin, rigjenerimin, rehabilitimin, konservimin, urbanizimin si për zona të reja dhe të territoreve për programet e strehimit social, etj.
- Krijimin e një hierarkie me dendësi më të lartë ndërtimore në zonat qendrore dhe më rrallë në drejtim të zonave të jashtme.
- Mbrojtjen e tokës bujqësore dhe natyrore.

4. Plani Strategjik 2030

Propozimi për një Plan Strategjik 2030 qëndron si një sintezë e skenarëve të lartpërmendur që kanë si objektiv arritjen e një Zhvillimi të Qëndrueshëm.

Qëndrueshmëria është një koncept i lashtë dhe modern në të njëjtën kohë, i shkaktuar nga një sërë vlerash, të cilat kanë një rol shumë të gjerë dhe të rëndësishëm në disiplinat individuale dhe shkenca, bartëse të një ndryshimi të rëndësishëm paradigmatic. Plani Strategjik paraqet transformimin e të menduarit strategjik (afatgjatë) të periudhës së tanishme historike dhe ndikon në të gjitha fushat e veprimtarisë njerëzore që përfshin shkencën, kulturën, etikën, filozofinë, politikën, fenë, biznesin, etj., bazuar në dëshirën për t'u pajtuar me natyrën, duke pranuar plotësisht rolin e palëve të interesuara për brezat e ardhshëm.

Plani Strategjik Lokal integrohet me Strategjitë Kombëtare, në nivelin e Prefekturës, duke u përballur me bashkitë e tjera, si dhe duke përcaktuar veprime specifike të përmbledhura më poshtë.

- *Për sistemin urban* parashikohet të arrihet një ekuilibër midis zonave të ndërhyrjes dhe zonave të zgjerimit, si brenda dhe jashtë perimetrit të qytetit, zonave banuese edhe zonave prodhuese, me një sistem të përqendruar fuqishëm në infrastrukturën lidhëse.
- *Për sistemin e infrastrukturës* janë planifikuar përmirësime të rrjetit aktual, në veçanti përta i përket lidhjeve të brendshme midis qyteteve, fshatrave dhe bashkive fqinje, duke përfshirë edhe mirëmbajtjen dhe përmirësimin e rrjetit ekzistues.
- *Për sistemin bujqësor* janë planifikuar projekte infrastrukturore të zonës, dhe veçanërisht për integrimin dhe zgjerimin e strukturës ekzistuese, si në lidhje me sistemin bujqësor, edhe me formimin e zinxhirëve të prodhimit, përpunimit, paketimit dhe shpërndarjen e produkteve lokale.
- *Për sistemin natyror* janë planifikuar ndërhyrje infrastrukturore, dhe veçanërisht për shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve të peizazhit dhe pyjeve. Kjo nëpërmjet zbatimit të një sistemi itinaresh të integruar me realizimin e infrastrukturave së turizmit dhe të agroturizmit, me një ndikim të ulët në mjedis.
- *Për sistemin ujor* janë planifikuar rrizhvillimi dhe vlerësimi i burimeve ujore, kryesisht nga ana e mjedisit dhe e peizazhit, si edhe shfrytëzimi produktiv i vetë burimeve.

5. Përfshirja e grupeve të interesit dhe dëgjesat publike

Një aspekt që e ka karakterizuar qasjen strategjike të planifikimit ka qenë ai i lidhur me rolin e koordinimit të vendimeve dhe proceseve me grupet e interesit.

Për të patur zgjidhje sa me efektive, është synuar një bashkëpunim sa më i frytshëm në kuadrin e ndërtimit të një sistemi planifikimi të aftë të përmbajë kontributet nga pushteti lokal dhe nga baza. Efektshmëria e pjesëmarrjes qëndron në marrjen parasysh se zgjidhja e problemeve ndodh nëpërmjet vendosjes së problemeve në habitatin e vet, domethënë me anë të mënyrës që konsiston në rikornizimin e problemit, për ta parë atë në një mënyrë të re dhe për ta ripërcaktuar midis lidhjeve të ndryshme.

Përfshirja e grupeve të interesit që nga fazat e para të procesit, gjithashtu, i bën më të qarta konfliktet, në mënyrë që të jetë e mundur të merren parasysh, të studiohen ato për një vendimmarrje sa më efektive. Në këtë mënyrë favorizohet përgjegjshmëria e qytetarëve nëpërmjet informacionit dhe arsytimit të përbashkët në lidhje me situatat e ndryshme, duke u bërë më të lehta për t'u pranuar. Është e nevojshme që të gjitha grupet dhe profesionet të jenë të përfaqësuar, duke përfshirë jo vetëm institucionet, përfaqësuesit e shoqatave tregtare dhe të tjera si këto, por edhe qytetarët e pavarur të cilët dëshirojnë të marrin pjesë. Vëmendje duhet t'u kushtohet kategorive më “të dobëta”, të cilat nuk janë të përfaqësuar mirë (të papunët, të moshuarit, emigrantët, etj.). Plani Strategjik është konfiguruar si një mjet i përbashkët për të pasur një perspektivë të përpunimit të të dhënave, për të arritur më pas një organizim të territorit për një periudhë afatmesme dhe afatgjatë.

6. Analiza SWOT

PIKAT E FORTA	PIKAT E DOBËTA
SISTEMI URBAN: • Vendbanimet dhe zonat urbane të konsoliduara • Zona e konsoliduar industriale • Aktivitete të shumta minierash • Shërbimet publike dhe private si në qendrat e mëdha, ashtu edhe në fshatra • Nivelet e larta të marrëdhënieve shoqërore	SISTEMI URBAN: • Cilësia e ulët urbane, arkitektonike dhe estetike e hapësirave dhe ndërtesave • Aktiviteti industrial në zonën e braktisur • Aktivitetet e minierave jo të shfrytëzuara plotësisht • Mungesa e investimeve në sektorin industrial • Nivelet e ulëta të punësimit • Borxhi i sektorëve produktivë • Furnizimi i shërbimeve publike dhe private jo efikas dhe modern
SISTEMI NATYROR: • Vlerat mjedisore, ekologjike dhe natyrore: zonat e mbrojtura, Parku Kombëtar Shebenik-Jabllanicë, pyjet dhe zonat malore • Vlerat e peizazhit	SISTEMI NATYROR: • Miniera dhe aktivitetet industriale ndotëse • Mungesa e një sistemi të organizuar për asgjësimin/ trajtimin e mbetjeve • Ulja e bimësisë në zonat e pyllëzuara • Ndotja e burimeve mjedisore

SISTEMI BUJQËSOR: - Ekonomia bujqësore e konsoliduar dhe e përhapur Ekonomia lidhur me sektorin e blegtorisë dhe përdorimin e burimeve pyjore	SISTEMI BUJQËSOR: Sistemi i prodhimit bujqësor jo modern dhe efikas
SISTEMI UJOR: Burimet e cilësisë së ujit	SISTEMI UJOR: Ndotja e burimeve ujore
SISTEMI I INFRASTRUKTURËS - Vënd strategjik (qyteti kryesor, qytetet e mëdha dhe rrjeti rrugor) Infrastruktura rrugore kombëtare dhe transnacionale (lidhur me Elbasanin dhe Maqedoninë) - Strukturimi i territorit dhe i infrastrukturës	SISTEMI I INFRASTRUKTURËS: - Infrastruktura e degraduar - Mungesa e lidhjeve efikase Lidhja e Infrastrukturës me nivel të ulët - Infrastruktura rrugore jo efikase dhe rrjeti hekurudhor i braktisur

Tabela 1. Evidentimi i pikave të dobëta dhe të forta (1).

MUNDËSITË	RREZIQET
SISTEMI URBAN: - Rritja e qendrave urbane dhe fshatrave - Rizhvillimi dhe rritja e qytetit kryesor Rritja e vlerave të vendeve publike, shërbimeve dhe aktiviteteve Shfrytëzimi i zonave të prodhimit/shkëmbimit ekzistuese dhe përmirësimi i zonave ekzistuese ose të braktisura	SISTEMI URBAN: - Rënie në cilësinë e qendrave urbane dhe vendeve publike ,si në qendrat më të mëdha, ashtu edhe në fshatra - Rritja e degradimit e lidhur me vendet vakante dhe aktivitetet që nuk janë në përdorim (degradimi territorial dhe ekonomik) Rritja e niveleve të papunësisë
SISTEMI NATYROR: Potenciali turistik për zonën malore dhe zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm - Potenciali lidhur me vlerat mjedisore të pranishme, natyrore dhe ekologjike	SISTEMI NATYROR: - Shfrytëzimi i rrëmujshëm dhe rritjet e parregulluara në zonat e pyllëzuara Rritja e nivelit të ndotjes për shkak të veprimtarive të prodhimit dhe mbetjeve

SISTEMI BUJQËSOR: • Shfrytëzimi i aktiviteteve të larmishme dhe të specializuara bujqësore	SISTEMI BUJQËSOR: • Rritja e nivelit të prapambetjes dhe ulja e produktivitetit të zonave bujqësore
SISTEMI UJOR • Rizhvillimi dhe përmirësimi i sistemit të lumit (përmirësimi i niveleve të peizazhit dhe të ndotjes)	SISTEMI UJOR: • Rritja e nivelit të ndotjes (industriale, minierore dhe e mbeturinave)
SISTEMI I INFRASTRUKTURËS: • Përmirësimi i rrjetit hekurudhor dhe i rrjetit rrugor	SISTEMI I INFRASTRUKTURËS: • Prapambetja dhe rritja e nivelit të përjashtimit në lidhje me deficitin e infrastrukturës

Tabela 2. Evidentimi i mundësive dhe i rreziqeve

Analiza SWOT (e njohur edhe si matrica SWOT) është një mjet i planifikimit strategjik i përdorur për të vlerësuar pikat e forta, dobësitë, mundësitë dhe rreziqet e një projekti, në rastin tonë të planifikimit vendor të një territori, dhe shërben për të marrë një vendim për të arritur një qëllim (3). Analiza mund të përqendrohet në mjedisin e brendshëm (duke analizuar anët e forta dhe të dobëta) dhe/ ose të jashtëm në një territor të caktuar (duke analizuar rreziqet dhe mundësitë).

Për hartimin e planit strategjik dhe propozimeve për PPV Librazhd, matrica SWOT ka analizuar të dy mjediset që ndërveprojnë dhe ndikojnë tek njëri-tjetri.




Figura 1. LIBRAZHD – PLANI STRATEGJIK 2030 (1)

7. Plani i veprimit

PPV parashikon që të zbatohet objekte specifike të Planit të veprimit, që janë vlerësuar në bazë të kriterëve specifike të para-fizibilitetit/ teknike dhe fizibilitetit ekonomik, përmbajtja e të cilave është:

1. Përkufizimi i karakteristikave funksionale dhe teknike të punës që do të kryhet;
2. Përcaktimi i kërkesave të projektit që do të hartohet, karakteristikat dhe lidhjet me kontekstin në të cilin kryhet ndërhyrja, marrja e masave të duhura për të mbrojtur vlerat, mjedisin kulturor dhe peizazhin;
3. Analiza e shkurtër e teknikave të ndërtimit, treguesit dhe rregullat teknike për t'u aplikuar;
4. Përcaktimi i një programi kohor;
5. Vlerësimi i përgjithshëm i kostove të ndërhyrjes;
6. Grafikët shpjegues të përpunuar (4).

7.1 Analiza e fizibilitetit ekonomik dhe financiar të Planit

Për vlerësimin e investimeve të planifikuara nga PPV, përcaktohet një analizë specifike e fizibilitetit ekonomik dhe financiar të Planit në tërësi, e cila vlen për të vlerësuar zbatimin dhe realizimin e tij, në kushtet e një ekuilibri ekonomik- financiar, në shkallë më të gjerë, si në rastin e PPV. Kjo analizë lejon vlerësimin e rikthimit të kapitalit të investuar, madje mundësinë për tërheqjen e investitorëve të mundshëm dhe lejon të kontrollohet paraprakisht nevoja për financim, si dhe të përcaktohet sasia, cilësia nga disa hipoteza:

- Vlerat e projektit (kërkesat hapësirë, akomodim, etj.);
- Hipoteza alternative të realizimit;
- Supozimet alternative të financimit;
- Përcaktimi i sasive (ndoshta e ndarë në lote);
- Përcaktimi i kostove të ndërtimit/ realizimit;
- Përcaktimi i të ardhurave të pritshme (përcaktimi i çmimit);
- Përcaktimi i kohës së realizimit (Gantt) dhe situatës ekonomike (4).

Rezultatet

Hartimi i PPV ka ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme territorin në krahasim me gjendjen aktuale sidomos në lidhje me:

- Propozimin e një zone të re banimi në LIBRAZHDI;
- Zonat e reja të kufizuara në zgjerim në fshatrat (Qender, Hotolisht, Lunik, Stebleve, Orenje, Polis);
- Rikualifikimin e zonës së stacionit të hekurudhës;
- Zgjerimin e zonës industriale;
- Riaktivizimin e sistemit të minierave;
- Identifikimin e zonave për rihvillim të banimit;
- Zona bujqësore të brendshme dhe të jashtme në fshatra, në të cilën është përcaktuar një artikulum i tyre në një shumicë të zonave në funksion të veçantisë së tyre.
- Përcaktimin sa më të saktë të hapësirave për objekte të komunitetit, në çdo njësi administrative me një rritje të përgjithshme në zona, dhe në veçanti në zonat standarde rezidenciale të vendosura strategjikisht.
- Rritjen dhe ripërcaktimin e zonave për mbrojtjen dhe restaurimin e mjedisit.
- Identifikimin e rrjetit rrugor në ristrukturimin dhe projektet ku kjo nuk është përcaktuar në mënyrë të veçantë.
- Futjen e disa PDV, të përcaktuar në të njëjtën kohë me PPV, e destinuar për detajim të planit për zona të konsideruara strategjike, me udhëzime të veçanta për ndërhyrje nga ana e realizuesve.

Pra, në mënyrë të përmblodhur, mund të themi se PPV Librazhd ndalon zgjerimin në zonat rurale, rigjeneron tokat bujqësore, parashikon rritjen e punësimit dhe prodhimit për tregjet agro-ushqimore lokale. Mundëson riaktivizimin dhe ripërdorimin e sistemit të minierave të nikelit dhe të kromit. PPV Librazhd i lejon natyrës që të gjejë hapësirat ku mund të shprehë format e biodiversitetit, si brenda dhe jashtë kufijve të qytetit, duke u bërë një projekt ekonomik dhe politik. Ky plan synon zhvillimin e turizmit malor, bazuar në rritjen, vlerësimin dhe vënien në pah të rrjeteve të burimeve natyrore. Parashikon ripërdorimin e ndërtesave rurale për qëllime agroturistike, krijimin e një sistemi të rrugëve dhe shtigjeve, si edhe planifikimin e zonave rekreative dhe sportive. Ky është një plan që punon mjaft mbi cilësinë e hapësirave publike që shërbejnë për të identifikuar projekte

pilote për çdo qendër të njësive administrative dhe për çdo fshat. Ky plan kërkon të rikuperojë terrenet dhe ndërtesat që shërbejnë për aktivitetet prodhuese dhe artizanale, duke u kufizuar dhe limituar hapësirat e reja të ndërtimit për industrinë.

Pas analizave ekonomike, PPV Librazhd rekomandon rritjen e numrit të ndërmarrjeve, të cilat duke punuar së bashku në fushat e bujqësisë, pyjeve dhe të energjive të rinovueshme, do të jenë në gjendje të sjellin rigjenerimin e ekonomisë urbane, të sigurojnë forma të integritetit dhe të punësimit për qytetarët. Ky plan rrit mjaftueshëm shërbimet e infrastrukturës dhe objekteve të komunitetit, ndalon zgjerimin e parregullt dhe plotëson hapësirat pjesërisht të urbanizuara, duke i dendësuar dhe duke i zhvilluar ato sipas standardeve të një planifikimi të qëndrueshëm urban. Ky është një plan që punon në infrastrukturën lidhëse dhe në infrastrukturën për energji të gjelbër dhe të rinovueshme. Por mbi të gjitha, është një plan që e sheh prodhimin bujqësor dhe agroturizmin cilësor si pikën e tij më të fortë.

Projektet strategjike përcaktojnë sinergjitë ekonomike dhe territoriale që janë të nevojshme për të arritur një balancë të re ndërmjet sistemit urban dhe infrastrukturës së tij, sistemit bujqësor, sistemit natyror dhe atij të burimeve ujore.

Referenca

1. Plani i Përgjithshëm Vendor i Librazhdit, hartuar nga Bashkia Librazhd, Cooprogetti S.C.R.L, A&E Engineering, 2016-2017.
2. Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar.
3. *Analiza e Thelluar e Territorit*, neni 53 të VKM 671, date 29.07.2015.
4. Neni 54 Parashikimet e PPV-se; *Përmbajtja e planit të zhvillimit të territorit*, Pika 5, *Plani i veprimeve për zbatimin e PPV-së*.

Shënime: Ky shkrim është bazuar edhe në kriteret e përcaktuara në VKM dhe dokumentet si më poshtë vijon:

VKM nr. 671, “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit” datë 29.7.2015.

VKM Nr. 438, datë 2.7.2014 “Për miratimin e planit kombëtar për integrimin Evropian, 2014 – 2020”.

Strategjia e Decentralizimit 2015-2020, miratuar me VKM nr. 691, datë 29.07.2015.

Dokumenti i Politikave për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit në Shqipëri 2014-2018, Ministria e Zhvillimit Urban.

Europa 2020, “*Strategjia Europiane për rritje Inteligjente, të Qëndrueshme dhe Gjithëpërfshirës*”.

Neni 2, pika 19, të VKM Nr. 671, date 29.05.2015, përkufizimi i *Metabolizmit të Territorit*. *Analiza Metabolike e flukseve*.

Neni 33 të VKM nr. 671 datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”.

Ligji Nr. 8743, Datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” Neni 3, “Prona publike”, i ndryshuar.

Ligji Nr. 91, datë 28.02.2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor”.

Neni 84, Ligji i Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore Nr. 111/2012, datë 15.12.2012.